

# **DORACA**

**për mënyrën e raportimit për  
temat lokale  
dhe gazetarinë hulumtuese**

**Për mediat lokale**

Ky publikim është punuar për recensim nga ana e Agjencisë së SHBA-ve për zhvillim ndërkombëtar.

Në përgatitjen e tij merrnin pjesë German Fillkov dhe Sabina Fakiq.

Qëndrimet e autorit, të shprehura në këtë publikim, nuk i shprehin qëndrimet e Agjencisë së SHBA-ve për zhvillim ndërkombëtar ose të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Përktheu: Gjakush Kabashi

# Përmbajtja

<b>Hyrje.....</b>	<b>4</b>
<b>1. Roli i rritur i mediave lokale .....</b>	<b>6</b>
1.1 Si t'i përgjigjen mediat lokale rolit të rritur.....	7
1.2 Temat kyçe me rëndësi lokale .....	9
1.2.1 Buxheti i komunës .....	10
1.2.2 Zhvillimi ekonomik lokal .....	12
1.2.3 Sektori publik .....	13
1.2.4 Shëndetësia .....	14
1.2.5 Arsimi .....	15
1.2.6 Urbanizmi .....	16
<b>2. Hulumtimi dhe raportimi për korrupsionin.....</b>	<b>17</b>
2.1 Ku dhe çka të hulumtohet, ku ta kërkonti korrupsionin, si zhvillohet ai dhe si mund të pengohet? .....	19
<b>3. Gazetaria hulumtuese.....</b>	<b>23</b>
3.1 Çka është gazetaria hulumtuese? .....	23
3.2 Problemet e gazetarëve .....	24
3.3 Fazat në procesin e hulumtimit .....	25
3.3.1. Gjetja e temës për hulumtim .....	25
3.3.2. Parashtrimi i supozimit në hulumtim .....	25
3.3.3. Hartimi i strategjisë dhe planit të hulumtimit.....	26
3.3.4. Kërkimi dhe mbledhja e dokumenteve .....	26
3.3.5. Kërkimi i njerëzve dhe burimeve .....	27
3.3.6. Kërkimi në Internet .....	27
3.3.7. Vëzhgimi i drejtpërdrejtë në terren.....	28
3.3.8. Përcaktimi i kornizës kohore të hulumtimit .....	28
3.3.9. Vlerësimi i parave të nevojshme për hulumtimin .....	29
3.3.10. Organizimi i stories dhe vlerësimi i situatës.....	29
3.3.11. Kontrollimi përfundimtar i stories .....	30
3.3.12. Shkrimi dhe publikimi i stories .....	30
<b>4. Aspektet ligjore dhe etike .....</b>	<b>31</b>
4.1. Liria e informimit publik .....	32
4.2. Qasja e lirë deri te informatat me karakter publik .....	33
4.3. Mbrojtja e privatësisë dhe të dhënave personale.....	33
4.4. Shpifja dhe fyerja .....	34
4.5. Çështjet etike.....	34
4.6. Kodi i gazetarëve të Maqedonisë.....	35



# Hyrje

Një numër gjithnjë më i madh i popujve më shumë se 200 vjet pranojnë që gazetaria e lirë paraqet gurthemel të demokracisë. Kur hartohet kushtetuta e Republikës së re të pavarur të Maqedonisë, autorët i përfshinë këto dhe liri tjera themelore. Në Pjesën II-Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe qytetarit, janë të përfshira një varg nenesesh në të cilat numërohen këto liri. Në pjesën II, neni 16, në Kushtetutë përmenden shprehja e lirë e mendimit, liria e fjalës dhe ndalimi i censurës.

- Garantohet liria e besimit, ndërgjegjes, mendimit dhe shprehjes publike të mendimit.
- Garantohet liria e fjalës, paraqitjes publike, informimit publik dhe themelimit të lirë të institucioneve për informim publik.
- Garantohet qasja e lirë deri te informatat, liria e pranimit dhe transmetimit të informatave.
- Garantohet e drejta e përgjigjes në mjetet për informim publik.
- Garantohet e drejta e korrigjimit në mjetet për informim publik.
- Garantohet e drejta e mbrojtjes së burimit të informatës në mjetet për informim publik.
- Cenzura është e ndaluar.

Në mënyrë të njëjtë, para më shumë se 200 viteve, në Amerikë, amendamenti i parë i Kushtetutës së SHBA-ve dhe neni i parë i “Kartës së lirive” deklarorin:

*„Kongresi nuk do të sjellë ligj për themelim të religjionit ose ndalim të shprehjes së tij të lirë, ose cenim të lirisë së fjalës ose të gazetarisë; ose të së drejtës së njerëzve për t’u mbledhur në mënyrë të qetë dhe për të dhënë peticione deri te qeveria për përmirësim të padrejtësive.”*

Por, vetë futja e një teksti të tillë në kushtetutë, pa marrë parasysh në Maqedoni ose në Amerikë ose në cilindo shtet tjetër, edhe pse veçanërisht e rëndësishme si garanci themelore, vetvetiu nuk nënkupton zbatim aktiv ose realizim të përfitimeve prej këtyre lirive veçanërisht të rëndësishme. Për t’u realizuar ndikim pozitiv në shoqëri me potencial të plotë, për lirinë e fjalës dhe gazetarinë e lirë janë të nevojshëm “ithtarë” të cilët do t’i kuptojnë seriozisht këto liri dhe do të punojnë pandërprerë për t’u realizuar përfitimet në shoqëri.

Në Amerikë, pikërisht me mendimet dhe veprat e veta, Tomas Xhefersoni, autori i “Deklaratës së pavarësisë” dhe kryetari i tretë i SHBA-ve, u bë i njohur si një prej ithtarëve dhe mbrojtësve më të mëdhenj të lirisë së gazetarisë, lirisë së fjalës dhe të drejtës së qytetarëve për të qenë të informuar mirë për punën e qeverisë së tyre.



Derisa Maqedonia ballafaqohet me sfida në procesin e krijimit të kombit të lirë dhe të pavarur, me rëndësi esenciale është çështja e gazetarisë së lirë dhe e drejta, përkatësisht obligimi i qytetarëve për të qenë të informuar për punën e qeverisë së tyre. Qytetarët dhe gazetarët e kanë përgjegjësinë kyçe në këtë proces të ndërtimit të kombit. Me fillimin e procesit të decentralizimit të ingjerencave të caktuara prej qeverisë qendrore te komunat, këto sfida dhe përgjegjësi fituan një dimenzion të rëndësishëm të ri në nivel lokal në mbarë shtetin.

Për Maqedoninë, këto probleme janë të reja, por principet janë të vjetra disa shekuj, dhe tani janë veç më mirë të përcaktuara në praktikën, si të gazetarisë së përgjegjshme, ashtu edhe të qytetarisë së përgjegjshme. Është mirë që kur ata të cilët kanë role dhe përgjegjësi kyçe në këtë proces në Maqedoni u qasen detyrave të tyre, për një moment të ndalen për t'i lexuar dhe shqyrtuar mendimet dhe qëndrimet e luftëtarit të madh për gazetarinë e lirë dhe për qytetarët e informuar mirë. Më poshtë janë dhënë disa mendime të rëndësishme të Tomas Xhefersonit, të shkruara në kohën kur ai dhe bashkëqytetarët e tij ballafaqoheshin me disa prej sfidave më të rëndësishme me të cilat sot ballafaqohet Maqedonia:

*“Nuk njoh asnjë vend tjetër ku shoqëria ka fuqi superiore përveç në fuqinë e vetë njerëzve; dhe nëse mendojmë që nuk janë mjaft të arsimuar për ta shprehur kontrollin e tyre me të drejtën e tyre të dobishme të vendimmarrjes, shërimi nuk është që atyre t'u merret kjo*

*e drejtë, por që të informohen për të drejtën e tyre të vendimmarrjes.”*

*“Sikur të më linin të vendos a duhet të kemi qeveri pa gazeta, apo gazeta pa qeveri, për asnjë moment nuk do të kisha mëdyshje për të vendosur për këtë të dytën.”*

*“Gjithmonë kur njerëzit janë të informuar mirë, ata mund të mbështeten në qeverinë e tyre.”*

*“Aty ku gazetaria është e lirë dhe secili njeri di të lexojë, çdo gjë është e sigurt.”*

*“Edukojeni dhe informojeni tërë turmën e njerëzve... Ata janë mbështetja e vetme e sigurt për ruajtjen e lirisë suaj.”*

Ky doracak është përgatitur për t'u ndihmuar gazetarëve në Maqedoni që me sukses t'i realizojnë këto sfida të reja. Gjithashtu, ai ka për qëllim të ndihmojë në besimin që, gjatë procesit të decentralizimit, qytetarët do të jenë të informuar mirë për të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre në bashkësitë në mbarë shtetin.

*Dvejn Bird  
Drejtor i Projektit të USAID-it  
për vetëqeverisje lokale*

# Roli i rritur i mediave lokale

Me procesin e decentralizimit – mediat lokale fituan, në kuptimin e vërtetë të fjalës, rol kyç në përforcimin e transparencës dhe të përgjegjësisë së autoriteteve lokale. Tani, në pajtim me ingjerenca të ndara mes pushtetit qendror dhe lokal, cilësia e jetës së njerëzve në masë të madhe varet nga cilësia e politikave dhe nga efikasiteti i zbatimit të tyre edhe në nivel qendror, edhe në atë lokal.

Procesi i bartjes së një pjese të ingjerecave nga niveli qendror në atë lokal e decentralizoi edhe përgjegjësinë prej mediave nacionale në ato lokale për të shërbyer si kontrollore të cilësisë së punës së institucioneve në suaza të komunave. Së këndejmi, mediat lokale duhet më fuqishëm të punojnë për sigurimin e qarkullimit të lirë të informatave si mënyrë për të dhënë kontribut serioz ndaj qeverisjes së mirë në komunat e tyre.

Në kushte kur pushteti lokal ka ingjerenca në të gjitha sferat prej të cilave varet cilësia e jetës së njerëzve në një komunë, duke u nisur prej shërbimeve komunale, nëpërmjet shëndetësisë dhe arsimit, deri te zhvillimi ekonomik - është e domosdoshme të theksohet rëndësia që e fiton informimi me kohë i qytetarëve për të gjitha këto veprimtari. Vetëm qytetarë të informuar mund të bëjnë zgjedhje të drejtë dhe të bëjnë presion mbi pushtetin për ta realizuar atë që e ka premtuar dhe për të punuar në mënyrë efektive dhe të përgjegjshme në interes të të gjithë qytetarëve të komunës.

Mediat lokale duhet t'i japin zëshmëri bashkësisë për të gjitha çështjet e rëndësishme, duke mundësuar që në këtë mënyrë të ndikohet mbi vendimet e pushtetit në drejtim të afrimit maksimal deri te nevojat dhe interesi i qytetarëve, përkundër interesave politike ose personale të të zgjedhurve të pushtetit lokal. Nëse mediat nuk i përgjigjen këtij trendi të ri, ekziston rrezik serioz që qytetarët të jenë të përjashtuar nga pjesëmarrja aktive në ndërtimin e komunave sipas nevojave të tyre dhe rrezik që qeverisja e papërgjegjshme e pushtetit lokal t'i atribuohet faktorëve objektivë, e jo faktorëve subjektivë që e bllokojnë zhvillimin dhe përparimin e mjediseve lokale.

## 1.1

# Si t'i përgjigjen mediat lokale rolit të rritur

Nëse cilësia e jetës në një komunë gjithnjë më shumë varet nga cilësia e punës së institucioneve lokale dhe nëse mediat duhet t'i përgjigjen rolit të rritur në këtë drejtim, pyetja kyçe është se si të bëhet kjo. Përgjigjja e kësaj pyetjeje në shikim të parë komplekse është mjaft e thjeshtë: gjithkund dhe në secilën çështje duhet të kërkohet interesi i qytetarit.

Që të mund t'i përgjigjen rolit të rritur, mediat lokale duhet që zhvillimin e tyre të ardhshëm ta ndërtojnë mbi dy shtylla:

1. Ndjekja e interesit të qytetarëve në komunë dhe
2. Lokalizimi i temave nacionale.

Ndjekja e interesit të qytetarëve në komunë do të thotë që informatat të cilat i publikojnë mediat duhet të ofrojnë përgjigje ndaj çështjeve, temave dhe problemeve të cilat u interesojnë qytetarëve. Mediat gjithmonë duhet patjetër të ofrojnë përgjigje ndaj pyetjeve:

- Çka do të thotë kjo për qytetarët?
- A do të ketë kjo ndikim pozitiv apo negativ mbi qytetarët?
- Si mendojnë qytetarët për një temë ose çështje të caktuar?

Duke e marrë parasysh që cilësia e jetës në një mjedis lokal varet edhe nga politika të cilën e zbaton pushteti qendror, mediat lokale duhet patjetër që në afat të gjatë të fokusohen edhe në përforcimin e shtyllës së lokalizimit të temave nacionale. Kjo do të thotë që mediat lokale duhet të informojnë edhe për politikat dhe vendimet e pushtetit qendror nëpërmjet tregimit të drejtpërdrejtë të asaj se si ato vendime ndikojnë mbi qytetarët, bashkësinë afariste, ngjarjet politike dhe institucionet në mjedisin lokal.

Praktikisht, kjo do të thoshte që vendimi i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë për miratim të Ligjit për nxitje të punësimit duhet patjetër të zë vend



të rëndësishëm edhe në informimin e mediave lokale, edhe pse është sjellë nga pushteti qendror. Gjatë kësaj, për t'iu përgjigjur nevojave të bashkësisë lokale, ligji do të duhet të prezantohet nëpërmjet bisedës me përfaqësuesit e bashkësisë lokale afariste, të cilët do të vlerësojnë a do të ketë mundësi të shfrytëzohen përfitimet e parapara, si dhe nëpërmjet bisedës me njerëz të papunësuar për pritjet e tyre. Kjo qasje e lokalizimit të temave nacionale, përpos për rregullativën ligjore, duhet të zbatohet edhe në të gjitha vendimet tjera të rëndësishme dhe politikën e pushtetit qendror.

Dallimi në qasjen e mediave nacionale dhe lokale duhet të shihet vetëm në burimet me të cilat dhe nëpërmjet të cilave do të tregohet një temë e caktuar, përkatësisht do të paraqitet informata. Përkatësisht, secili mjedis ka bërthamë të vet afariste, rrethe politike, opinion publik të ekspertëve, sektor qytetar. Në fakt, pikërisht përfaqësuesit e bashkësisë lokale e dinë specifikën e mjedisit të tyre dhe mund të japin notë ose vlerësim real të asaj se si ndikon mbi bashkësinë lokale politika që krijohet dhe zbatohet në nivel qendror. Duke e rritur shkallën e informimit të bashkësisë lokale për ndikimin e politikave të pushtetit qendror mbi cilësinë e jetës dhe zhvillimin e komunës, njëkohësisht rritet edhe vetëdija e qytetarëve për çështjet e rëndësishme në shoqëri, e me këtë edhe aftësia e tyre për sjellje të vendimeve të drejta dhe për ndikim për efikasitet më të madh edhe të pushtetit qendror.

Duke e ndërtuar qasjen e këtyre qytetarëve në informim dhe duke ofruar informata gjithëpërfshirëse edhe për politikën lokale, edhe për ato nacionale, mediat lokale në të vërtetë investojnë në ardhmërinë e tyre. Përkatësisht, shkalla më e madhe e hapjes ndaj qytetarëve do të thotë edhe shikueshmëri/lexueshmëri/dëgjueshmëri më e lartë e mediave lokale. Sipas principit të enëve të lidhura, perceptueshmëria më e madhe e mediave për problemet e qytetarëve e rrit besimin në atë medium dhe i motivon qytetarët për pjesëmarrje edhe më aktive në ndodhitë në komunë.



## 1.2 Temat kyçe me rëndësi lokale

Që të munden mediat lokale t'i përgjigjen sfidës për t'i informuar qytetarët për tema të cilat janë të rëndësishme për ta dhe prej të cilave varet cilësia e jetës në bashkësitë lokale, ato duhet ta vënë fokusin në këto fusha:

- Buxheti i komunës
- Zhvillimi ekonomik lokal
- Sektori publik
- Shëndetësia
- Arsimi
- Urbanizmi.

Zgjedhja e temave është bërë ashtu që janë marrë jo vetëm ato sfera të cilat janë me rëndësi të madhe për qytetarët, por edhe sferat në të cilat pushteti lokal ka injerenca të rritura. Gjithashtu, këto janë sfera në të cilat puna dhe të arriturat në masë të madhe varen nga efikasiteti i pushtetit lokal. Pikërisht për këtë arsye është e domosdoshme që mediat ta drejtojnë vëmendjen e tyre kah këto sfera dhe vetë të inicojnë hulumtime gazetareske për ngjarjet në to.



## 1.2.1

### Buxheti i komunës

Buxheti është një prej çështjeve më të rëndësishme në komunë për të cilat duhet të informojnë mediat. Ai i pasqyron vendimet e pushtetit lokal në thuajse të gjitha sferat e veprimit, prej arsimit, nëpërmjet shëndetësisë, deri te tatimet dhe taksat, dhe së këndejmi ka ndikim të rëndësishëm mbi jetën e njerëzve. Duke e pasur parasysh këtë, pikërisht mediat duhet ta ngrenë edhe interesin e qytetarëve për këtë çështje të rëndësishme.

Viti fiskal në Republikën e Maqedonisë zgjat prej 1 janarit deri më 31 dhjetor, përkatësisht kjo është periudha e vlefshmërisë së buxheteve vjetore të shtetit dhe të komunave. Procesi i hartimit dhe sjelljes së buxhetit mund të zgjasë disa muaj dhe përfshin disa hapa kyçë. Së pari, secili departament në komunë dhe në institucionet lokale, të cilat financohen nga buxheti, deklarohet për nevojat që i ka për vitin e ardhshëm. Pastaj, mjetet e kërkuara harmonizohen me mundësitë e komunës, përkatësisht me të hyrat e planifikuara në buxhet. Pasi që të vijë deri te harmonizimi i nevojave dhe të hyrave, hartohet propozim-buxheti, i cili në fund jepet në adoptim nga ana e Këshillit të komunës, i cili ka të drejtë të ndërtojë në përmbytjen e tij. Të gjitha këto faza në procesin e vendimmarrjes në komunë janë të rëndësishme dhe mund të jenë interesante për lajm që duhet t'u komunikohet qytetarëve. Qasja e këtillë në raportim u mundëson mediave t'i përfshijnë qytetarët në vlerësimin e buxhetit - a i pasqyron ai nevojat e tyre, dhe me këtë hap mundësi për intervenime në pozicionet e propozim-buxhetit.

Për të raportuar në mënyrë cilësore dhe profesionale për sjelljen e buxhetit të komunës, gazetarët duhet patjetër të jenë paraprakisht të informuar mirë për bazat dhe esencën e buxhetit. Nëse nuk gjenden burime të përshtatshme, qoftë njerëz prej komunës ose ekspertë, buxheti mund të paraqesë vetëm një varg të zakonshëm të numrave që gazetari nuk do ta kuptojë, dhe së këndejmi nuk do të mundet as t'ua shpjegojë shikuesve/lexuesve/dëgjuesve të vet.

Gjatë raportimit për buxhetin, kyçe është të prezantohet dedikimi i tij, përkatësisht shërbimet për të cilat do të shpenzohen paratë. Gjatë kësaj, gazetari duhet të vlerësojë vetë se cilat janë pozicionet më të rëndësishme buxhetore për të cilat duhet të informohet, meqenëse është thjesht e pamundshme të thuhet dhe të shpjegohen të gjitha numrat.

Duke shkruar për buxhetin, gazetarët në të vërtetë duhet të ofrojnë përgjigje ndaj pyetjeve se si buxheti do të ndikojë mbi qytetarët; a do të fitojnë qytetarët më shumë ose më pak shërbime se sa vitin paraprak; a do të paguajnë qytetarët më shumë apo më pak për këtë. Në raportimin për buxhetin, gazetarët duhet të

#### **Në përgjithësi, raportimi për buxhetin duhet të përmbajë të dhëna për:**

- vlerën e gjithsej buxhetit të komunës,
- shkallën e rritjes, përkatësisht zvogëlimin të buxhetit në raport me vitin paraprak,
- arsyet për rritjen ose zvogëlimin e buxhetit (p.sh. rritja e buxhetit për shkak të punësimeve të reja në komunë),
- pasqyrën e pozicioneve më të rëndësishme të buxhetit (ato prej të cilave në pjesën më të madhe financohet arka komunale),
- informatë për atë se si ndryshime të caktuara do të pasqyrohen në jetën e njerëzve,
- vlerën dhe përshkrimin e projekteve më të rëndësishme investuese që financohen prej buxhetit.

informojnë edhe për qëndrimin e qytetarëve rreth çështjeve më të rëndësishme në lidhje me buxhetin, si dhe në lidhje me projektet më të mëdha që do të financohen nga arka komunale. Njëkohësisht, është e rëndësishme t'u kushtohet vëmendje edhe dallimeve eventuale politike në shqyrtimin e buxhetit të propozuar, përkatësisht asaj se cili grup i këshilltarëve për çka angazhohet.

Mediat lokale duhet ta kenë parasysh atë që buxheti është çështje për të cilën duhet të raportohet gjatë tërë vitit, e jo vetëm në ditën e adoptimit të tij nga ana e Këshillit të komunës. Gjatë kësaj, është e dobishme nëse gjatë raportimit buxheti shihet edhe nëpërmjet dy pozicioneve kyçe:

- Prej ku vijnë paratë (të hyrat)?
- Ku shkojnë paratë (të dalat)?

Për përcjellje të të hyrave buxhetore, me rëndësi është të theksohet që në pozicionin e të hyrave vetjake të njërive të vetëqeverisjes lokale hyjnë tatimet në pasuri, të hyrat nga kompenzimet për shërbime, nga puna e ndërmarrjeve të themeluara nga komuna, taksat, etj. Komunitat marrin përqindje prej tatimit personal në të ardhura dhe prej tatimit në vlerën e shtuar, kurse për sigurim të parave plotësuese për financim të komunave është paraparë edhe sistem i dotacioneve, përkatësisht transfereve plotësuese prej buxhetit.

Gjatë kësaj, është shumë e rëndësishme të përcillen të hyrat e planifikuara dhe të arkëtuara të komunës për t'u vlerësuar realizimi, pastaj të hyrat e vitit vijues në krahasim me vitin paraprak për t'u vlerësuar trendi në arkëtim (a është pozitiv apo negativ), etj. Njëkohësisht, duhet të kihet parasysh që nëpërmjet përcjelljes së arkëtimit të të hyrave mund të jepet vlerësim për aktivitetin ekonomik në komunë, si dhe për efikasitetin në punën e administratës tatimore.

Mënyra më praktike për përcjelljen e asaj se si shpenzohen paratë buxhetore është nëpërmjet furnizimeve publike. Gjatë kësaj, është e rëndësishme që mediat lokale t'i përcjellin dhe të informojnë për të gjitha furnizimet më të mëdha publike në komunë, prej shpalljes së thirrjes për furnizimin deri te realizimi i furnizimit.



### Rekomandime për raportimin për buxhetin:

- Raportoni edhe për procesin e hartimit të propozim-buxhetit, e jo vetëm për aktin e adoptimit të tij nga Këshilli i komunës;
- Mësoni ta lexoni dhe ta interpretoni buxhetin;
- Rriteni mundësinë për ndikim të qytetarëve mbi projektet buxhetore;
- Detyrojeni pushtetin të shpjegojë si dhe pse do t'i shpenzojë paratë;
- Kini parasysh që transparenca është garancia kyçe për shpenzim racional të parave të komunës dhe prandaj përcillni dhe raportoni si shpenzohen paratë e buxhetit.

## 1.2.2

### Zhvillimi ekonomik lokal

Raportimi për ekonominë e prek jetën e secilit qytetar. Papunësia, çmimet e prodhimeve, investimet - të gjitha këto janë tema të cilat e zgjojnë interesin jo vetëm të bashkësisë afariste, por edhe të qytetarëve si punëtorë dhe konsumatorë. Raportimi për zhvillimin ekonomik lokal do të thotë raportim për të gjitha ngjarjet në ndërtimtari, komunikacion, prodhimtari, bujqësi, tregti, turizëm, përkatësisht për tërë atë që e lëviz ekonominë lokale.

Gazetarët duhet rregullisht t'i informojnë qytetarët për rezultatet që i ka arritur pushteti lokal në realizimin e të a.q. Strategji për zhvillim ekonomik lokal, duke mos lejuar që strategjitë e këtilla të komunave të ndryshme të mbeten vetëm listë e projekteve dhe planeve ambicioze që nuk do të realizohen asnjëherë. Është e nevojshme të përcillen ngjarjet në sektorin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe të informohen qytetarët për atë se çka është bërë në drejtim të përkrahjes së zhvillimit të tyre.

Mediat lokale duhet vazhdimisht të bëjnë presion pozitiv mbi pushtetin lokal në drejtim të zgjidhjes së problemeve më të mëdha ekonomike në komunë, siç janë papunësia dhe varfëria. Në drejtim të nxitjes së zhvillimit ekonomik, është e rëndësishme të inicohen debate të cilat duhet t'i ndihmojnë njësisë së vetëqeverisjes lokale për financim të projekteve të rëndësishme, për të cilat nuk ka të hyra të mjaftueshme vetjake, nëpërmjet shfrytëzimit të fondeve të para-anëtarësimit të Bashkimit Evropian.

Mediat lokale nuk duhet të mbyllën në komunat e tyre. Është e nevojshme të shohin edhe te njësitë tjera të vetëqeverisjes lokale për të ardhur deri te shembuj pozitivë dhe për të informuar për projekte të cilat do të mund të realizoheshin edhe në komunën e tyre. Krahasimet e këtilla duhet të shërbejnë si mënyrë për nxitje të autoriteteve lokale për të treguar rezultate më të mira në zhvillimin e komunës. Njëkohësisht, në fokus të mbulimit medial duhet të jenë edhe mundësitë për projekte të përbashkëta të më shumë komunave. Kuptohet, përpos krahasimit me komunat tjera më të zhvilluara, është e domosdoshme që në mediat lokale të promovohen edhe shembuj pozitivë në zhvillimin ekonomik lokal në shtetet fqinje.

Gjatë raportimit për zhvillimin ekonomik, duhet të shmanget rreziku që tekstet gazetareske të shndërrohen vetëm në konstatim të dallimeve mes pritjeve të qytetarëve dhe arsytimeve të autoriteteve lokale që zhvillimi ekonomik varet kryesisht nga pushteti qendror. Prandaj është e domosdoshme që në listën e burimeve të gjenden ekspertë ekonomikë të cilët kanë kredibilitet në mjedisin lokal për t'i interpretuar gjërat dhe për t'i vlerësuar realisht injerencat dhe mundësitë e pushtetit lokal.



#### Rekomandime për raportimin për zhvillimin ekonomik lokal:

- Raportoni për mënyrën se si pushteti lokal ballafaqohet me problemet më të mëdha ekonomike;
- Kërkoni përgjigje prej autoriteteve lokale: çka bëjnë për ta përmirësuar klimën afariste dhe për ta nxitur sipërmarrësinë;
- Zbuloni a zbatohet dhe si zbatohet plani për zhvillim ekonomik lokal, çka kanë premtuar, e çka kanë realizuar kryetari i komunës dhe këshilltarët;
- Hulumtoni dhe informoni çka bëjnë deputetët e njësisve tuaja zgjedhore në interes të qytetarëve nga komuna juaj dhe
- Kërkoni më shumë nga njësitë rajonale të pushtetit qendror: me çfarë efikasiteti punojnë, a u përgjigjen nevojave lokale?

## 1.2.3 Sektori publik

Sektori publik në këtë aspekt duhet të kuptohet në kuptim më të gjerë të fjalës, përkatësisht administrata komunale dhe ndërmarrjet dhe institucionet publike që punojnë në suaza të bashkësisë lokale. Cilësia e punës së sektorit publik në një komunë është në të vërtetë pasqyrim i suksesshmërisë së asaj komune. Në të vërtetë, vetëqeverisja lokale ekziston për t'ua mundësuar këto shërbime qytetarëve të vet. Duke u nisur nga shikimi i këtyre gjërave, rrjedh që mediat duhet t'ua mundësojnë shikuesve/dëgjuesve/lexuesve të vet të gjitha informatat relevante në bazë të të cilave ata do të mund ta vlerësojnë suksesshmërinë e punës së ndërmarrjeve dhe shërbimeve komunale.

Mediat duhet ta tregojnë raportin e përfaqësuesve të zgjedhur të pushtetit lokal ndaj parave të përbashkëta dhe institucioneve të përbashkëta. Gjatë kësaj nuk guxon të harrohet që partitë politike të cilat e marrin besimin e qytetarëve në zgjedhje shpeshherë për struktura udhëheqëse në ndërmarrjet dhe institucionet publike vënë njerëz sipas kriterëve partiakë, farefisnore dhe miqësore, në vend se sipas profesionalizmit dhe kompetencës. Ajo që është kyçe është që me qasjen e këtyre krijohet ambient në të cilin vendimet në këto ndërmarrje dhe institucione pastaj sillen nga interesi partiak ose personal, e jo nga interesi i qytetarëve në komunë, të cilët edhe i financojnë, edhe i shfrytëzojnë shërbimet e ndërmarrjeve dhe institucioneve publike.

Mediat duhet ta kenë parasysh që me raportin e këtyre suspendohet interesi i qytetarit dhe zvogëlohet cilësia e shërbimeve që ato u japin qytetarëve. Ekspertët juridikë e gjejnë pikënisjen për partizimin e këtyre të sektorit publik në rregullativën ligjore "të varfër dhe tepër të përgjithshme", me të cilën definohet zgjedhja e anëtarëve në bordet drejtuese të ndërmarrjeve dhe institucioneve publike. Ligji për ndërmarrje publike (2006) u dedikon vetëm një nen kriterëve për emërim të anëtarëve në bordet drejtuese të ndërmarrjeve publike. Në të thuhet që "*në bordin drejtues, themeluesi emëron, përkatësisht shkarkon përfaqësues nga radhët e ekspertëve të afirmuar dhe të njohur në fushën e lëndës së punës së ndërmarrjes publike...*" Nga ana tjetër, në praktikë nuk respektohet as korniza e këtyre ligjore të varfër dhe tepër të përgjithshme për zgjedhje të anëtarëve të bordeve drejtuese. Janë të shumtë shembujt e emërimit të anëtarëve, të cilët sipas kualifikimeve të përcaktuara jo vetëm që nuk janë profesionistë dhe të afirmuar në fushën në të cilën punon ndërmarrja, por shpeshherë nuk kanë as pikë prekëse me atë fushë.

Pikërisht këtu është roli i mediave që t'i përcjellin këto emërime, t'i informojnë qytetarët për obligimet ligjore dhe zgjidhjet praktike dhe pastaj të përcjellin si punon sektori publik në komunë dhe nëpërmjet numrave dhe treguesve konkretë t'ua japin qytetarëve argumente për kënaqësi ose pakënaqësi nga puna e njësisë të vetëqeverisjes lokale. Mediat duhet t'i përkrahin qytetarët të kenë pasqyrë të vazhdueshme dhe të plotë të punës së ndërmarrjeve dhe institucioneve publike, duke u nisur nga ajo çka është planifikuar dhe çka është realizuar dhe çfarë cilësie e shërbimit publik është fituar për paratë e shpenzuara.

### Rekomandime për raportimin për zhvillimin ekonomik lokal:

- Raportoni si punojnë ndërmarrjet dhe institucionet lokale publike (çfarë është pastërtia në qytet, si është gjendja e rrugëve, etj.);
- Kërkoni përgjigje të tri pikave kyçe: a janë qytetarët të kënaqur nga shërbimet e ndërmarrjeve publike; çfarë rezultatesh financiare realizojnë ndërmarrjet publike dhe si udhëhiqet me ndërmarrjet dhe kush e kontrollon punën e tyre;
- Raportoni për punën e administratës lokale. Bisedoni me bashkëqytetarët tuaj - sa janë të kënaqur nga puna e administratës në shërbime të caktuara. A i kanë të qarta kriteret dhe kushtet për marrje të lejeve dhe vendimeve prej shërbimeve të caktuara lokale;
- Informoni jo vetëm për problemet dhe joefikasitetin e administratës, por edhe për përvojën e mirë, për shkak se në këtë mënyrë do t'i jepni nxitje edhe të tjerëve.

## 1.2.4 Shëndetësia

Qytetarët në përgjithësi janë maksimalisht të interesuar për tema nga shëndetësia, për shkak se prej gjendjes në sektorin shëndetësor në komunën e tyre, si dhe prej cilësisë së shërbimeve shëndetësore që i marrin, në fund të fundit varet edhe jeta e tyre. Duke e pasur parasysh këtë, institucionet shëndetësore gjithnjë më shpesh gjenden nën presion për transparencë dhe llogaridhënie të rritur në punë, kurse mediat gjenden para sfidës për t'iu përgjigjur interesit të qytetarëve për informim të rregullt për ngjarjet në shëndetësi.

Duke e pasur parasysh interesimin e madh të njerëzve për këtë temë, mediat mund të gjejnë lajm prej sektorit shëndetësor në secilin çrregullim të ngjarjeve vijuese, kallaballëk në institucione, mungesë të barërave, aparate të prishura, pakënaqësi të pacientëve, kushte të këqija për punë të personelit mjekësor, etj. Mediat duhet ta rrisin skepticizmin gazetaresk gjithmonë kur në sektorin shëndetësor, përkundër pakënaqësisë së pacientëve, dikush pohon që gjërat shkojnë mirë dhe që bëhet fjalë për përpjekje maksimale.

Në raportimin për shëndetësinë publike duhet patjetër të kihen parasysh interesat e kundërta në këtë sferë të tregtarëve të barërave me shumicë dhe të sektorit privat shëndetësor. Prandaj mediat duhet me kujdes t'iu hulumtojnë ngjarjet në këtë sektor. Gjendja e mospasjes së kapaciteteve spitalore dhe barërave në proporcion me nevojat krijon hapësirë që secili shërbim urgjent të paguhet në mënyrë plotësuese. Ky është rast kur pa rend bëhen incizime, kontrole dhe operacione të ndryshme dhe fitohen krevate spitalore, me ç'rast involvohen jo vetëm mjekë, por edhe personel tjetër mjekësor dhe administrativ. Mjekë të caktuar e shfrytëzojnë gjendjen e këtyre për t'iu udhëzuar pacientët prej shëndetësisë publike drejt ordinancave private, ku ata punojnë pasdite ose në kohën e tyre të lirë. Në këtë mënyrë, pozita e besuar në llogari të shtetit shfrytëzohet për realizim të dobisë personale dhe institucionet publike shëndetësore shfrytëzohen si vend për rekrutim të pacientëve për ordinancat dhe klinikat private.

Në fund, gjithmonë kur mediami duhet të publikojë storie nga shëndetësia, të lidhur për ndonjë investim të ri, për zgjerim të kapacitetit të ri ose për pajisje të re mjekësore, gazetarët duhet t'iu parashtrojnë vetes një varg pyetjesh, nëpërmjet të cilave do të vijnë deri te informatat e nevojshme për atë se a është vendimi përgjigje e nevojave të vërteta të shfrytëzuesve të shërbimeve shëndetësore ose pas blerjes dhe investimit fshihet interesi personal i dikujt. Duke e marrë parasysh atë se reformat në shëndetësi janë në vijim e sipër, mediat lokale duhet patjetër rregullisht ta përcjellin zbatimin e këtyre reformave nëpërmjet prizmit të ndikimit të tyre mbi institucionet e caktuara shëndetësore në komunë.



### **Rekomandime për raportimin për shëndetësinë:**

- Në çfarë kushtesh gjenden institucionet shëndetësore, a i kanë në dispozicion të gjitha mjetet dhe barërat e nevojshme mjekësore;
- A janë qytetarët të kënaqur nga kushtet në institucionet shëndetësore dhe nga puna e tyre;
- Kërkoni përgjigje dhe përgjegjësi për ngjarjet edhe prej institucioneve kompetente shëndetësore në nivel qendror (Ministria e shëndetësisë dhe Fondi i shëndetësisë, etj.).

## 1.2.5 Arsimi

Duke e marrë parasysh atë që arsimi është një prej shtyllave të zhvillimit të bashkësisë lokale dhe të shoqërisë në përgjithësi, mediat duhet rregullisht të informojnë për këtë sferë, edhe atë prej dy aspekteve. Aspekti i parë janë kushtet në të cilat zhvillohet procesi arsimor në bashkësinë lokale, kurse i dyti është cilësia e mësimdhënies.

Gjendja në shkollat fillore dhe të mesme nga aspekti i pamjes dhe ndërtimit të tyre është vetëm ajo pjesë e dukshme e problemeve arsimore për të cilat duhet të raportohet. Por, njëkohësisht, theksi duhet të vihet edhe mbi sigurimin e kushteve për zhvillim optimal të secilit nxënës, shikuar nëpër prizmin e numrit të nxënësve në një paralele, mundësisë së mësimdhënësve t'i kushtojnë vëmendje të domosdoshme secilit nxënës, mjeteve ndihmëse mësimdhënëse-treguese të cilat u qëndrojnë në dispozicion për shfrytëzim, etj.

Përpos kësaj, mediat duhet të informojnë edhe për plotësimin e kushteve të barabarta arsimore të garantuara me ligj, pa marrë parasysh prejardhjen e nxënësve, statusin e tyre shoqëror dhe material, si dhe përkatësinë e tyre fetare dhe nacionale. Nëpërmjet raportimit, mediat duhet ta rrisin rolin e prindërve dhe të grupeve tjera të interesuara për ndikim mbi përmirësimin e cilësisë së arsimit. Njëkohësisht, janë të domosdoshme edhe analiza për cilësinë e arsimit në një komunë nëpërmjet prezantimit të rezultateve që i arrijnë nxënësit, edhe atë nëpërmjet krahasimit prej vitit në vit ose me komuna tjera.

Duke i pasur parasysh ingjerenat e komunave, mediat duhet të raportojnë çka është bërë në drejtim të avancimit të sistemit të arsimit në komunë, a bën departamenti kompetent në komunë analizë të rregullt të punës së shkollave, a ka kontrolle të rregullta inspektuese, cilat masa dhe aktivitete janë ndërmarrë për avancim të punës së shkollave, etj. Duke e marrë parasysh vargun e problemeve që u paraqitën në periudhën e kaluar, mediat duhet t'i përcjellin edhe zgjedhjet e ndërmarrjeve që kryejnë transport të organizuar në shkolla, të ndërmarrjeve furnizuese me ushqim, si dhe të ndërmarrjeve që i organizojnë ekskursionet shkollore. Në përgjithësi, nëpërmjet raportimit të rregullt, analizave të thella dhe storieve hulumtuese, mediat jo vetëm që do t'i informojnë qytetarët me kohë dhe në mënyrë gjithëpërfshirëse për ngjarjet në këtë sferë, por do t'u mundësojnë edhe të gjitha palëve të interesuara të ndikojnë mbi avancimin pozitiv të sistemit mësimdhënës dhe arsimor, që duhet të prodhojë kuadër cilësor që do të kontribuojë drejt zhvillimit dhe përparimit të komunës.



### Rekomandime për raportimin për arsimin:

- Informoni për cilësinë e mësimdhënies (pyetni - sa nxënës ka në një klasë, a mundet të gjithëve t'u kushtohet vëmendje, a kanë mjete të mjaftueshme mësimdhënëse-treguese, etj.);
- Përcillni kushtet në të cilat punojnë shkollat (vizitoni shkollat me kamerë dhe foto-aparat);
- Iniconi involvim më të madh në punën e shkollave nga ana e këshillave të prindërve;
- Nëse në komunën tuaj ka universitet, përcillni ngjarjet edhe atje dhe përpuni ta shfrytëzoni potencialin e ekspertëve të kuadrit universitar në drejtim të shpejtimin të zhvillimit të komunës.

## 1.2.6 Urbanizmi

Raportimi në këtë sektor duhet të jetë i orientuar drejt inicimit të pjesëmarrjes më të madhe të qytetarëve në procesin e planifikimit urbanistik dhe të pengimit të organeve inspektuese për t'i toleruar ndërtimet pa leje. Gazetarët duhet të kenë parasysh që një plan urbanistik i planifikuar dhe i zbatuar mirë nuk do të thotë vetëm pamje e bukur e komunës, por edhe kushte cilësore për jetë dhe punë në bashkësinë lokale.

Përkundrazi, kaosi urbanistik që çdo ditë krijohet në komuna e vështirëson zhvillimin ekonomik dhe kulturor të komunës, e çon prapa biznesin dhe cilësinë e jetës në komunë. Zgjidhjet urbanistike duhet të jenë të tilla që do ta përmirësojnë jetën, do ta shkurtojnë dhe do ta lehtësojnë transportin dhe do ta nxisin zhvillimin e tërësishtëm në komunë. Së këndejmi, ngjashëm si edhe në arsim dhe shëndetësi, qytetarët në secilën bashkësi lokale kanë interes jetësor për çështjet nga fusha e urbanizmit dhe ata kanë të drejtë që drejtpërdrejt të marrin pjesë në krijimin e planeve urbanistike në bashkësinë në të cilën jetojnë.

### Rekomandime për raportimin për arsimin:

- Informoni thëllësisht për planin e detajuar urbanistik, ku dhe çka është paraparë të ndërtohet;
- Kërkoni qasje deri te plani i detajuar nëse hulumtoni ndonjë lokacion ose ndërtim kontestues;
- Hulumtoni si punon shërbimi i inspektoratit në komunë;
- Përfshini qytetarët në të gjitha debatet e këshillave komunalë për zgjidhjet e caktuara urbanistike.



# Hulumtimi dhe raportimi për korrupsionin



Sipas Ligjit për pengim të korrupsionit (2004), me korrupsion nënkuptohet shfrytëzimi i funksionit, autorizimit publik, detyrës dhe pozitës zyrtare për realizim të çfarëdo qoftë dobie për vete ose për tjetërkënd. Nevoja dhe rëndësia e hulumtimit të korrupsionit dhe të asaj që mediat të raportojnë për të rrjedhin nga pasojat e shumëfishta dhe serioze që i ka korrupsioni në të gjitha sferat e jetës dhe punës. Korrupsioni i varfëron njerëzit, e keqëson cilësinë e shërbimeve publike, e zvogëlon efikasitetin e administratës publike dhe të ndërmarrjeve dhe institucioneve publike, e dëmton aftësinë konkurruese, i largon investimet e vendit dhe të huaja, e pengon zhvillimin ekonomik dhe e çon prapa demokracinë në shtet.

Shumë hulumtime tregojnë për përhapje të gjerë të korrupsionit në thuajse të gjitha sferat e jetës dhe punës në Maqedoni. Duke i pasur parasysh pasojat e dëmshme të korrupsionit dhe rolin tepër të madh që e kanë mediat në pengimin e korrupsionit, gazetarët duhet patjetër edhe më shumë të hulumtojnë dhe të raportojnë për rastet e korrupsionit. Kjo assesi nuk është detyrë e thjeshtë, meqenëse nuk është aspak lehtë të zbulohet dhe të dëshmohet ky lloj i krimit, kryesisht për shkak të interesit të ndërsjellë të pjesëmarrësve të heshtin dhe ta fshehin atë që e kanë bërë.

Mes tjerash, bazë për atë që gazetarët dhe mediat ta hulumtojnë dhe të raportojnë për korrupsionin jep edhe Ligji për pengim të korrupsionit (2004), i cili në nenin 6 thotë që "Ekzekutimi i pushtetit, autorizimeve publike, detyrës dhe pozitës zyrtare, si dhe i punëve me interes publik janë publike dhe i nënshtrohen kontrollit publik. Askush nuk mund të thirret në aplikimin e ligjit ose të ndonjë akti tjetër me të cilin do të kufizohet ose do të përjashtohet publiku për t'u fshehur shfrytëzimi i funksionit, autorizimeve publike, detyrës dhe pozitës zyrtare për realizim të dobisë, volitshmërisë ose përparësisë për vete ose për tjetërkënd".

Prapëseprapë, duke e marrë parasysh që kur mediat raportojnë për korrupsion, zbulojnë gjëra që disa njerëz ose institucione dëshirojnë të mbeten fshehtësi, në Republikën e Maqedonisë, si edhe në shumë shtete tjera në botë, gazetarët ballafaqohen me shumë pengesa në rrugën e informimit profesional dhe objektiv për korrupsionin. Për t'ia hapur hapësirën mediave dhe gazetarëve të



hulumtojnë dhe të informojnë për korrupsionin, i njëjti Ligj për pengim të korrupsionit në nenin 62 "ndalon çfarëdo qoftë detyrimi, pengimi ose ndikimi në ndonjë mënyrë tjetër mbi mjetet për informim publik të publikojnë ose të mos publikojnë informata për raste të korrupsionit. Gazetari ka të drejtë të qasjes së papenguar deri te të gjitha burimet e informatave në pajtim me ligjin. Askush nuk mund ta përjashtojë publikun nga diskutimi për korrupsionin para organit kompetent ose personit juridik, përveç kur bëhet fjalë për procedurë paraprake që është shpallur e besueshme. Askush nuk mundet prej gazetarit që ka publikuar informatë për akt të korrupsionit të kërkojë ta zbulojë burimin e informatës, përveç se në procedurë para gjyqit".

Nga ana tjetër, ligji i njëjtë e pengon keqpërdorimin e mediave për fajësim të pabazë dhe të rrejshëm të tjetërkujt për korrupsion. Neni 63 thotë që "secili që publikon informatë për korrupsion të tjetërkujt, është i obliguar që ta respektojë pafajësinë e supozuar dhe principet e informimit të vërtetë, objektiv dhe të paanshëm, si dhe principe tjera të kodit të etikës profesionale. Askush nuk mund të shfrytëzojë ndonjë mjet të informimit publik për fajësim të rrejshëm të tjetërkujt për korrupsion.

Që të munden gazetarët ta hulumtojnë korrupsionin dhe ta informojnë publikun e tyre për rastet e korrupsionit, së pari duhet patjetër që ata vetë të dinë cilat janë fushat që janë më së shpeshti të goditura nga korrupsioni, përkatësisht ku ta kërkojnë korrupsionin. Tenderi i "rregulluar" për furnizim publik ose kërkimi i ryshfetit për kryerje të një shërbimi të caktuar janë vetëm ndër format më të njohura të korrupsionit. Ekzistojnë edhe shumë forma dhe skema tjera të përpunuara të korrupsionit për të cilat gazetarët duhet patjetër të dinë nëse dëshirojnë t'i hulumtojnë dhe t'i publikojnë ato. Gjithashtu, gazetarët, me ndihmën e ekspertëve, duhet vazhdimisht t'i vënë në pah edhe mënyrat për atë se si të ngushtohet hapësira për korrupsion. Vetëm në këtë mënyrë, nëpërmjet zbulimit të korrupsionit dhe nëpërmjet të kallëzimit të përmirësimeve të mundshme të gjendjes, mediat mundën me sukses ta luajnë rolin e tyre në luftën kundër korrupsionit, e me këtë edhe në avancimin dhe përmirësimin e standardit jetësor dhe mirëqenies së bashkëqytetarëve të tyre, qoftë në nivel nacional apo lokal. Sfidat në këtë rrugë janë të shumta dhe të mëdha, por nuk ka asgjë më të rëndësishme në një shoqëri demokratike se sa vendosja dhe ndjekja e standardeve themelore të punës profesionale në të gjitha sferat e jetës. Mes tyre, edhe në profesionin gazetaresk dhe në punën e pushtetit lokal.

## 2.1

# Ku dhe çka të hulumtohet, ku ta kërkonti korrupsionin, si zhvillohet ai dhe si mund të pengohet?

Një prej fushave që më së shumti i nënshtrohen korrupsionit janë furnizimet publike. Me vetë këtë, ato paraqesin fushë që duhet patjetër vazhdimisht të gjendet nën vëzhgimin e zgjuar të gazetarëve. Nëpërmjet furnizimeve publike në të vërtetë realizohen funksionet themelore të komunës, përkatësisht shpenzohen paratë e buxhetit komunal, duke blerë mallra, shërbime dhe kryerje të punëve.

Mënyrën dhe procedurën për kryerje të furnizimeve publike i rregullon Ligji për furnizime publike (2007), dhe ato kanë të bëjnë me organet e pushtetit shtetëror, organet e njëjësive të vetëqeverisjes lokale, ndërmarrjet publike dhe shoqatat në të cilat shteti ose njësitë e vetëqeverisjes lokale kanë kapital dominant, shoqatat e qytetarëve dhe fondacionet të cilave u janë dhënë autorizime publike, si dhe personat juridikë të cilët kryejnë shërbime të posaçme publike. Neni 12 i Ligjit për furnizime publike përcakton që “punët në lidhje me zhvillimin e sistemit të furnizimeve publike, si dhe sigurimin e racionalitetit, efikasitetit dhe transparencës në zbatimin e furnizimeve publike i kryen Byroja për furnizime publike, si organ i administratës shtetërore në kuadër të Ministrisë së financave”.

Furnizimet publike në nivel nacional dhe lokal përfshijnë shuma tepër të mëdha të parave (më shumë se një miliardë euro). Konsiderohet që pikërisht për shkak të shumave të këtylla të mëdha të parave në furnizimet publike kjo fushë i nënshtrohet aq shumë korrupsionit. Nga ana tjetër, duke e pasur parasysh që në punët korruptive marrin pjesë të dyja palët, përkatësisht edhe ata që i realizojnë furnizimet, edhe furnizuesit, është në interesin e tyre të përbashkët që ta fshehin atë që e kanë bërë. Sipas vlerësimeve të burimeve kompetente nga sektori publik dhe privat, korrupsioni e shtrenjton një pjesë të furnizimeve publike për madje 30% të vlerës së tyre reale. Me dhënien e furnizimeve publike ofertuesve të favorizuar për shkak të realizimit të dobisë personale, konsiderueshëm zvogëlohet cilësia e mallrave, shërbimeve dhe punëve të kryera të blera, dëmtohet konkurrenca në treg dhe nuk realizohet qëllimi i furnizimeve.

### **Korrupsioni në furnizimet publike zhvillohet kryesisht nëpërmjet mënyrave në vijim:**

- specifikimi i tenderit për furnizimin përshtatet në të mirë të ndërmarrjes së favorizuar ofertuese nëpërmjet futjes së performancave të tilla që vetëm ajo ndërmarrje do të mund t'i plotësojë,
- kriteret për caktim të pikëve “rregullohen” ashtu që të fitojë ndërmarrja e favorizuar, duke dhënë më së shumti pikë për kriteret me të cilat ndërmarrja qëndron më së miri,
- furnizimi artificialisht ndahet në furnizime më të vogla për t'u shmangur obligimi për zbatim të tenderit publik dhe për t'u mundësuar zbatimin e procedurës për të a.q. furnizim të vogël,
- konkurrimi me çmim jo realisht të ulët vetëm për t'u fituar furnizimi, e pastaj, në pajtim me blerësin, ngritja e çmimit nëpërmjet pozicionit të “shpenzimeve të papaparapara”,
- ndarja e barabartë e furnizimit në të gjitha ndërmarrjet të cilat kanë konkurruar në tender, me çka “futen” edhe ndërmarrje të afërta të cilat përndryshe nuk kanë oferta cilësore,
- rregullimi i tri ofertave të nevojshme në rastet e të a.q. “furnizim i vogël” ashtu që oferta e ndërmarrjes së favorizuar të dalë më e volitshme, dhe
- kontrolli i dobët i realizimit të furnizimit, që shfrytëzohet për të mos u realizuar deri në fund ajo që është ofertuar në tender.

Rekomandimi kryesor për hulumtimin e rasteve të korrupsionit në furnizimet publike është të përcillen furnizimet prej fillimit deri në fund, përkatësisht prej idesë dhe nevojës për furnizimin deri te realizimi i tyre përfundimtar. Nuk duhet të harrohet që korrupsioni mund të qëndrojë edhe në vendimin çka të blihet. A është ajo diçka që është me të vërtetë e nevojshme dhe gjendet në plane ose blihet diçka vetëm që ndërmarrjet e favorizuara të realizojnë profit.

Kur hulumtohen furnizimet publike, gjithmonë duhet të insistoni që të fitoni të dhëna për ndërmarrjet që i kanë fituar tenderët. Gazetarët dhe opinioni publik kanë të drejtë t'i dinë këto informata meqenëse bëhet fjalë për para të qytetarëve që duhet të shpenzohen racionalisht dhe në pajtim me qëllimin e caktuar. Duhet t'i kontaktoni edhe ndërmarrjet që i fitojnë tenderët, edhe ato që nuk kanë fituar në tender për ta pasur pasqyrën e plotë të ngjarjeve dhe për të bërë storie objektive.

Përpos nëpërmjet furnizimeve publike, korrupsioni në administratën komunale dhe te ndërmarrjet dhe institucionet publike ekziston edhe në procesin e dhënies së shërbimeve nga administrata ose ndërmarrjet dhe institucionet nëpërmjet marrjes së kompenzimit financiar ose material për shërbimin e kryer. Lartësia e ryshfetit varet nga lloji i shërbimit që e kërkon qytetari ose ndërmarrja, nga rëndësia e shërbimit për ta, nga shpejtësia me të cilën dëshirojnë ta fitojnë shërbimin dhe nga interesi material që e kanë nga shërbimi i kryer. Edhe pse shumat e parave në rastet individuale korruptive janë në përgjithësi të vogla, kjo formë e korrupsionit është aq shumë e përhapur dhe ka depërtuar aq shumë në shumë pore të imta të shoqërisë, sa që marrë në përgjithësi bëhet fjalë për shumë serioze të parave që fitohet në mënyrë të paligjshme.

### **Konsiderohet që gjeneratorë kyçë të korrupsionit në këtë fushë janë:**

- shfrytëzimi i ngadalshmerisë dhe joefikasitetit të administratës dhe kërkimi i ryshfetit për shpejtim të procedurave,
- gatishmëria e qytetarëve dhe ndërmarrjeve të paguajnë ryshfet për të marrë një shërbim të caktuar ose për ta marrë atë për kohë më të shkurtër se sa koha e përcaktuar e rregullt,
- kriteret, kushtet dhe procedurat e ndërlikuara, jo mjaft të qarta dhe jotransparente për marrje të shërbimeve dhe për miratim të lejeve dhe vendimeve të ndryshme, me ç'rast dërgohen sinjale deri te qytetarët dhe ndërmarrjet që të ofrojnë diçka si kundërvlerë për zgjidhjen e problemit,
- interesi i të dyja palëve për të heshtur meqenëse njëra palë (qytetarët dhe ndërmarrjet) e ka marrë shërbimin, kurse pala tjetër (nëpunësit) ka realizuar të hyra shtesë.



Gjatë hulumtimit dhe përcjelljes së rasteve të korrupsionit në procesin e dhënies së shërbimeve nga ana e administratës komunale dhe ndërmarrjeve dhe institucioneve publike duhet të kërkohen palë eventualisht të pakënaqura, të cilat haptazi do të flitnin për rastet, të hulumtohet e vërteta e rryshfetit në mjedisin në të cilin jetohet, të bëhen rang-lista të institucioneve dhe shërbimeve që janë fole më të mëdha të korrupsionit dhe të bisedohet haptazi me qytetarët për atë se çka mendojnë ata për problemin dhe si e shohin zgjidhjen e tij.

Fusha tjetër në të cilën duhet të hulumtohen rastet e korrupsionit dhe të raportohet për to është ndërtimi pa leje. Bëhet fjalë për veprimtari në të cilën korrupsioni është masovikisht i pranishëm. Nuk ka komunë në Maqedoni në të cilën secilin vit nuk regjistrohen dhjetëra ndërtime të reja që nuk kanë leje për ndërtim, dhe të cilat, nga ana tjetër, asnjëherë nuk shemben. Prandaj, nuk do të gaboni nëse, si gazetar, e kontrolloni secilin objekt që fillon të ndërtohet se a i ka lejet dhe miratimet e nevojshme.

Ajo që e stimulon korrupsionin në këtë fushë është që fitimet nga ndërtimet banesore janë shumë të larta dhe lëvizin edhe deri në 100% të kapitalit të investuar, ashtu që ekziston interes i madh për ndërtim dhe para të mjaftueshme për rryshfet. Sipas hulumtimeve, korrupsioni në këtë fushë arrin deri në instancat më të larta edhe në pushtetin qendror, edhe në atë lokal. Kjo ndodh posaçërisht kur bëhet fjalë për ndërtim të objekteve në lokacione atraktive.

Gjatë hulumtimit të rasteve të korrupsionit në këtë fushë, rekomandohet që ta hulumtoni raportin e autoriteteve në komunën tuaj ndaj ndërtimeve të egra, sa janë konzistente autoritetet në zbatimin e vendimeve për shembje, kush janë ata objektet e të cilëve nuk janë shembur edhe pse kanë vendim për shembje, e kush janë ata mbi objektet e të cilëve ligji zbatohet në mënyrë konzistente. Gjithashtu, duhet patjetër që si gazetarë vazhdimisht ta kërkoni prapavijën në tolerimin e investitorëve kur disa nuk i respektojnë ligjet dhe aktet në këtë fushë.

Arsimi dhe shëndetësia janë fushat vijuese në të cilat gazetarët duhet ta hulumtojnë korrupsionin, për shkak se në këto fusha ai ka pasoja afatgjate. Në arsim, ekzistimi i korrupsionit dhe mospublikimi i tij e sjell rrezikun që nxënësit dhe studentët të fitojnë shprehje korruptive që në procesin e formimit të personalitetit të tyre. Nga ana tjetër, edhe pse në aktivitete korruptive është përfshirë vetëm një pjesë e kuadrit mësimdhënës, nëpërmjet fshehjes së korrupsionit degradohet tërë ky profesion shumë i rëndësishëm. Krejt kjo e bën problemin e korrupsionit në arsim shumë serioz.

Duke e hulumtuar korrupsionin në arsim, gazetarët duhet patjetër të kenë parasysh që gjithnjë më rrallë realizohet rryshfeti tradicional me para, e gjithnjë më shpesh në funksion janë forma tjera më të sofistikuara të korrupsionit. Kështu, në lojë futen të a.q. ndërmjetësues, nëpërmjet të cilëve realizohen rastet korruptive, nxënësve u sugjerohen orë plotësuese të mësimdhënësi ose ndonjë i afërt i tij jashtë



### **Korrupsioni në urbanizëm, nëpërmjet ndërtimit pa leje dhe tolerimit të tij, është i mundur për shkak të shkaqeve në vijim:**

- ndryshimi i shpeshtë i planeve urbanistike, që i nxit investitorët të fillojnë të ndërtojnë në mënyrë joligjore, e pastaj nëpërmjet pagimit të rryshfetit të ndikojnë që të futen në planet e ardhshme urbanistike,
- mosballafaqimi me problemin që nga zanafilla e tij, me çka, pasi që të hyjnë njerëz dhe ndërmarrje në ato ndërtime, problemi bëhet problem social,
- arsyetimi që në buxhetet komunale nuk ka para për shembje dhe prandaj nuk shemben ndërtimet e egra, me çka në të vërtetë fshihet puna e paligjshme.

mësimi të rregullt, kurse simpatia e mësimdhënësve fitohet edhe nëpërmjet prodhimeve dhe kundër-shërbimeve të ndryshme, varësisht nga nevojat e mësimdhënësve dhe nga biznesi që e kanë prindërit e nxënësve. Gjithashtu, duhet të kihet kujdes edhe për zgjedhjen e agjencive turistike nëpërmjet të cilave organizohen ekskursionet e nxënësve, zgjedhjen e teksteve shkollore prej të cilave do të mësohet, zgjedhjen e restoranteve për festimin e maturës, zgjedhjen e qytetarëve dhe ndërmarrjeve të cilave u jepen me qira pjesë të shkollave dhe, që është po aq e rëndësishme - për atë se ku përfundojnë paratë nga kjo qira dhe a paraqiten diku këto të hyra.

Rekomandimet kryesore për përcjellje të korrupsionit në arsim janë që gazetarët më shumë ta hulumtojnë këtë problem të pranishëm, por të fshehur, të bisedojnë më shumë me nxënësit për këtë problem, duke u garantuar gjatë kësaj atyre anonimitet, dhe më shpesh t'i vizitojnë shkollat në komunën e tyre.

Edhe sektori shëndetësor është seriozisht i rrezikuar nga korrupsioni. Këtu, korrupsioni zhvillohet në dy segmente kryesore: gjatë furnizimit me barëra, materiale dhe pajisje mjekësore dhe gjatë dhënies së shërbimeve shëndetësore qytetarëve. Në segmentin e parë, korrupsioni realizohet nëpërmjet blerjes së barërave me çmime shumë më të larta se sa ato reale, blerjes së sasive shumë më të mëdha se sa ajo që është e nevojshme me qëllim të fitimit të bonusit në sasi, furnizimeve pa tenderë, krijimit artificial të nevojës për furnizim urgjent për t'u shmangur realizimi i tenderit, etj. Në pjesën e dhënies së shërbimeve, ekzistojnë madje edhe të a.q. çmime për lartësinë e ryshfetit varësisht nga lloji i shërbimit dhe profesionalizmi i mjekut. Prapëseparë, fakti që bëhet fjalë për shëndetin e njeriut dhe që njerëzit janë të gatshëm të japin çdo gjë e bëjnë korrupsionin në shëndetësi një prej më të fshehurve në shoqëri.

Gjatë zbulimit dhe përcjelljes së korrupsionit në shëndetësi, gazetarët duhet më shpesh të bisedojnë me qytetarët dhe pacientët për përvojën e tyre, duke u garantuar gjatë kësaj anonimitet, duhet posaçërisht të hulumtohen furnizimet në institucionet shëndetësore, të hulumtohet lidhshmëria e mjekëve dhe drejtorëve të institucioneve me tregtarët e barërave me shumicë, si dhe të kërkohen raste të konfliktit të interesave të mjekët nga sektori publik për shkak të lidhshmërisë së tyre me ordinaanca private.

## **Gazetarët duhet ta kenë parasysh që korrupsioni në arsim, mes tjerash, është i mundur nga:**

- institucionet dhe mekanizmat e dobët për mbrojtje të nxënësve, të cilët do ta paraqitnin korrupsionin,
- interesi personal i studentëve dhe nxënësve, të cilët janë të përfshirë në korrupsion, për të heshtur për ryshfetin e dhënë,
- solidariteti i heshtur të mësimdhënësit për kolegët e tyre të korruptuar, të cilët në këtë mënyrë mbesin të pandëshkuar, kurse problemi mbetet i pazgjidhur.

## **Këtë korrupsion e mundësojnë:**

- mosekzistimi i procedurave të qarta gjatë furnizimit me barëra, material dhe pajisje mjekësore, si dhe shtyrja e zbatimit të plotë të të a.q. çmime referente për furnizim me këto prodhime,
- mosmbajtja e evidencës precize materiale të institucionet shëndetësore për barërat e shpenzuara dhe për rezervat,
- kontrolli, transparenca, përgjegjësia dhe llogaridhënia e dobët të institucionet shëndetësore,
- mospasja e kapaciteteve të mjaftueshme spitalore dhe barërave në pajtim me nevojat, me çka lihet hapësirë që secili shërbim urgjent të paguhet në mënyrë plotësuese,
- lidhshmëria e mjekëve me furnizuesit që përcaktojnë provizione për barërat e blera ose të caktuara në recetë,
- konsiderimi i ryshfetit si shprehje e falënderimit për sëmundjen e shëruar dhe për jetën e shpëtuar njerëzore.



# Gazetaria hulamtuese

## 3.1

### Çka është gazetaria hulamtuese?

Edhe pse disa e definojnë gazetarinë hulamtuese thjesht si gazetari e mirë, kurse të tjerë si raportim i thellë për një temë të caktuar, gazetaria hulamtuese është më shumë se kaq. Gazetaria hulamtuese nënkupton hulamtim që është realizuar nga ana e vetë gazetarit dhe në bazë të iniciativës së tij, dhe me të cilin zbulohet diçka që një person ose organizatë e caktuar nuk dëshiron të zbulohet. Së këndejmi, rrjedh që të jesh gazetar hulamtues do të thotë të qenët shumë më tepër proaktiv se sa reaktiv.

Gazetaria hulamtuese do të thotë të “preket” në sipërfaqen e ndodhive ditore për t’u thënë njerëzve çka po ndodh në të vërtetë, ashtu që do t’u ofrojë përgjigje pyetjeve “pse” dhe “si”, e jo vetëm pyetjeve “kush”, “çka”, “kur” dhe “ku”. Duhet të kihet parasysh që për t’u bërë një storie hulamtuese nevojitet kohë dhe përpjekje. Me storien hulamtuese zbulohet diçka që është vështirë të dëshmohet, meqenëse njerëzit dhe institucionet e përfshira në atë rast kanë interes të ndërsjellë që askush mos ta marrë vesh atë që e kanë bërë.

#### **Për t’u kuptuar më mirë çka është stória hulamtuese, duhet të kihet parasysh elementet e këtyre storieve:**

- Storia hulamtuese zbulon dhe ka të bëjë me ndonjë problem sistemor, e jo vetëm me ndonjë rast të caktuar të izoluar që e prek vetëm një njeri.
- Storia hulamtuese e zbulon punën e gabueshme të institucioneve dhe individëve dhe ka të bëjë me diçka që më së shpeshti zhvillohet fshehtëzi.
- Storia hulamtuese tregon që gjërat nuk funksionojnë ashtu siç duhet të funksionojnë dhe jep indikacione për korrupsion, padrejtësi ose keqpërdorim të pushtetit.
- Storia hulamtuese bazohet në hulamtimin personal dhe origjinal të gazetarit, dhe nuk paraqet vetëm transmetim të rezultateve të hetimit të realizuar nga organet shtetërore hetimore.
- Storia hulamtuese është e mbështetur me dokumente dhe bazohet në intervista gjithëpërfshirëse dhe prandaj kërkon më shumë burime se sa storiet tjera gazetareske.
- Storia hulamtuese, si dhe të gjitha storiet tjera gazetareske, duhet patjetër të jetë interesante për publikun dhe të ketë të bëjë me njerëzit dhe jetën e tyre të përditshme.

## 3.2

# Problemet e gazetarëve

Menjëherë në fillim, që nga definimi i gazetarisë hulumtuese, duhet ta kemi të qartë që nuk duhet lehtë të biem në arsyetimet pse nuk mundemi ose nuk guxojmë të merremi me këtë gazetari. Me probleme gjatë hulumtimit ballafaqohet gazetarët në thuajse të gjitha shtetet në botë, e jo vetëm gazetarët në shtetin tonë.

### **Problemet më të shpeshta që qëndrojnë në rrugën e gazetarisë hulumtuese janë:**

- Mungesa e informatave dhe dokumenteve me të cilat do të vërtetohen disa njohuri.
- Frika te redaktorët dhe pronarët e mediave që të publikojnë storie me të cilat mund ta sjellin mediumin në konflikt me struktura të caktuara politike.
- Frika dhe redaktorët dhe pronarët e mediave të publikojnë storie me të cilat mund të provokojnë tërheqje të porosive reklamuese prej ndërmarrjeve të caktuara dhe shpallësve tjerë.
- Pamundësia dhe mosinteresimi i mediave t'u japin gazetarëve vëmendje dhe para të posaçme për hulumtime më afatgjate.
- Autocenzura te gazetarët për të punuar në storie hulumtuese për shkak të të gjitha arsyeve të lartpërmendura dhe për shkak të frikës për sigurinë e tyre personale.

Këto dhe shumë probleme tjera të ngjashme që paraqiten paralelisht me gazetarinë hulumtuese janë universale për shumë shtete në të gjitha kontinentet. Por, këto probleme gjithsesi nuk duhet t'u vënë në mëdyshje në kërkimin e të vërtetës dhe zbulimin e informatave që disa njerëz dhe institucione dëshirojnë të mbeten fshehtësi. Prandaj, duhet të jeni këmbëngulës në kërkimin e informatave. Shfrytëzoni mundësitë që i ofron Ligji për qasje të lirë deri te informatat me karakter publik (2006) dhe thirruri në dispozitat kushtetuese për lirinë e informimit (neni 16 i Kushtetutës së RM-së).

Nëse në mediumin tuaj nuk ju japin kohë të mjaftueshme për hulumtim, më së miri është që vetë ta gjeni atë ashtu që në storien tuaj hulumtuese do të punoni para dhe pas përfundimit të obligimeve tjera ditore në redaksi. Gjithashtu, përpiquni t'i bindni redaktorin dhe pronarin e mediumit për rëndësinë e publikimit të njohurive deri te të cilat keni arritur gjatë hulumtimit. Në fund të fundit, kjo e ngrit besimin e publikut në mediumin tuaj, e me këtë edhe shumë më tepër shpallës do të duan të shpallin reklama në të. Mos të flasim për atë që publikimi i storieve hulumtuese i zgjeron liritë e gazetarëve dhe qasjen deri te informatat dhe e përforcon rolin e gazetarëve dhe të mediave në shoqëri.

## 3.3

### Fazat në procesin e hulumtimit

Vetë emërtimi “storie hulumtuese” tregon për atë që këto storie, para së gjithash, përfshijnë ndonjë hulumtim të caktuar. Ky është proces që realizohet në disa faza, prej idesë për temën e hulumtimit deri te publikimi i stories dhe përcjellja e reaksioneve dhe rezultatit.

#### 3.3.1.

#### Gjetja e temës për hulumtim

Temat të cilat vlejné të hulumtohen janë të shumta dhe gjenden gjithandej. Gazetari mund të arrijë vetë deri te ato, duke e shfrytëzuar kureshtjen e vet, ose nëpërmjet ndonjë burimi. Storiët më të mira hulumtuese vijnë prej njerëzve të cilët duan që opinioni publik të mësojë diçka për dikë ose për ndonjë institucion. Më tutje, burim i shkëlqyeshëm i një storieje hulumtuese mund të jenë njerëzit dhe ndërmarrjet e mllfosura, ndaj të cilave është bërë padrejtësi, dhe që vendosin t’u ankohen gazetarëve. Gjithashtu, një storie e mirë hulumtuese mund të rrjedhë prej ndonjë bisede në shikim të parë të përditshme me fqinjët dhe miqtë, ose prej ndonjë mbledhjeje të zakonshme të informatave prej ndonjë institucioni të caktuar për një storie krejt tjetër. Duhet të jeni vazhdimisht të zgjuar për shkak se storiët e mira hulumtuese shpeshherë vijnë prej lëvizjeve rutinore të reporterëve. Thjesht - një storie hulumtuese ndonjëherë mund të rrjedhë prej pyetjes kureshtare pse diçka është ashtu siç është.

#### 3.3.2.

#### Parashtrimi i supozimit në hulumtim

Pasi që për diçka do të “vijë era” e stories së mirë hulumtuese, gjëja e ardhshme që duhet të bëhet është të parashtrihen supozime të caktuara në hulumtim. Pikënisja më e mirë në këtë kuptim është të përcaktojmë si duhet të funksionojnë gjërat për të parë se çka nuk funksionon në atë mënyrë. Pastaj, duhet të pyetemi kush janë ata që fitojnë, e kush janë ata që humbin nga një situatë e caktuar. Dhe, që në fillim, duhet t’i parashtrojmë dy pyetjet kyçe - “pse” dhe “si”. Pse gjërat rrjedhin në një mënyrë të caktuar dhe si rrjedhin ato saktësisht. Me ndjekjen e këtyre hapave dhe me përgjigjen e të gjitha këtyre pyetjeve, mund të parashtrihen baza dhe supozime të mira për hulumtimin e më tutjeshëm. Në këtë fazë në të vërtetë ne precizojmë çka do të hulumtojmë.

### 3.3.3. Hartimi i strategjisë dhe planit të hulumtimit

Gjëja e ardhshme që duhet të bëhet janë strategjia dhe plani i hulumtimit. Ato janë të nevojshme për të shërbyer si një lloj i kompasit gjatë hulumtimit. Storit hulumtuese janë të ndërlikuara dhe gjithëpërfshirëse dhe kërkojnë t'u kushtohet kohë, përpjekje dhe durim i konsiderueshëm, dhe në shumë raste madje edhe fond i posaçëm i parave. Strategjia e hulumtimit dhe plani punues për realizimin praktik të hulumtimit do të ndihmojnë që hulumtimi të realizohet deri në fund dhe të mos ketë shmangie dhe vonesa të panevojshme. Si bazë për hartim të strategjisë mund të shërbejnë pyetjet vijuese: cili do të jetë fokusi ynë i hulumtimit (çka dëshirojmë të dëshmojmë), cilat dokumente na nevojiten, cilët njerëz dëshirojmë (duhet) t'i intervistojmë, çka mund të kërkojmë në Internet e çka duhet të hulumtojmë në terren. Gjithashtu, duhet të përcaktojmë cila do të jetë korniza kohore e hulumtimit dhe a na nevojitet ndonjë fond i caktuar i parave (dhe sa është ai). Në këtë fazë duhet t'ua prezantojmë redaktorëve temën dhe hulumtimin dhe t'i bindim ata në arsyeshmërinë dhe rentabilitetin e tyre.



### 3.3.4. Kërkimi dhe mbledhja e dokumenteve

Storit hulumtuese bazohen në dokumente. Që në strategjinë e hulumtimit duhet t'i shënojmë të gjitha dokumentet që do të na nevojiten për ta dëshmuar storien. Gjurmet e dokumentuara mbesin pas secilit person, institucion, ngjarje afariste ose dukuri. Duhet vetëm të dimë çka na nevojitet dhe si të vijmë deri te ato dokumente.

Të dhënat që na nevojiten mund t'i gjejmë në komunë, ndërmarrjet dhe institucionet publike, ministritë dhe njësitë e tyre rajonale, në Qeveri, në Regjistrin qendror, në Berzë, në Komisionin për letra me vlerë, në Entin statistikor. Gjithashtu, burime të rëndësishme të informatave mund të jenë raportet e Entit shtetëror për auditim dhe të Komisionit për anti-korrupsion, si dhe raportet shkollore, mjekësore, gjyqësore, policore, etj. Një pjesë e madhe e dokumenteve janë publike ose së paku duhet të jenë publike. Kërkojeni secilin dokument që mendoni që ju nevojitet, pa supozuar a do t'jua japin apo jo. Ndonjëherë dokumentet janë madje edhe më shumë në dispozicion se sa që mund të supozoni. Thirruni në dispozitat kushtetuese për lirinë e informimit dhe për obligimin e njerëzve dhe institucioneve për ta informuar opinionin publik. Nëse ballafaqoheni me vështirësi në sigurimin e dokumenteve, kërkoni ndihmë në Ligjin për qasje të lirë deri te informatat me karakter publik. Mos i kërkoni gjithmonë dokumentet te ata që i publikojnë ato. Kërkoni ato edhe nga pala tjetër, përkatësisht nga ata që i pranojnë ato. Mos u dekurajoni nëse marrja e një dokumenti të caktuar e shtyn tërë hulumtimin. Gjithashtu, kini parasysh që dokumentet janë burimi primar, por nuk janë edhe burimi i vetëm në hulumtim. Dokumentet dhe materialet e shkruara nuk janë të mjaftueshme për shkak se edhe ato, si edhe njerëzit, ndonjëherë mund të mos e thonë të vërtetën, për shkak se, në fund të fundit, edhe dokumentet janë shkruar prej njerëzve.



### 3.3.5. Kërkimi i njerëzve dhe burimeve

Dokumentet e mbështesin, por njerëzit janë ata që e bëjnë storien. Pasi që t'i sigurojmë të gjitha dokumentet e nevojshme për storien hulumtuese, duhet të mendojmë mirë se me cilët njerëz do të duhej të flasim dhe t'i intervistojmë për t'i bashkuar të gjitha pjesët në mozaikun e stories. Përpos aktorëve kryesorë në storie, përkatësisht atyre që fitojnë dhe atyre që humbin nga problemi ose procedura, na nevojiten njerëz që kanë parë çka ka ndodhur, si dhe njerëz me njohuri profesionale të problematikës. Nuk duhet gjithmonë së pari t'i kërkojmë njerëzit e parë në institucione. Ndonjëherë burime shumë të mira mund të jenë njerëzit e të a.q. eshalon i dytë, përkatësisht ata që gjenden më poshtë në strukturën hierarkike të organizatës. Gjithashtu, në secilin rast duhet të përqijemi të bisedojmë edhe me ata njerëz që më parë kanë qenë në funksionet ose vendet e punës që janë lëndë e hulumtimit tonë në storie. Të shkarkuar prej pasojave, këta njerëz shpeshherë mund të na japin informata shumë të rëndësishme për kuptim më të mirë të kontekstit të problemit ose dukurisë.

### 3.3.6. Kërkimi në Internet

Interneti është mundësi e shkëlqyeshme që të vini deri te informata dhe dokumente shumë të rëndësishme për hulumtimin tuaj, por edhe deri te njerëz të cilët do të mund t'i intervistonit. Në Internet mund të gjeni informata të prapavijës (bekgraund) për storien, t'i hulumtoni përvojën dhe praktikën në shtetet tjera, të mësoni kush dhe çka ka folur për temën që e hulumtoni, të vini deri te informata biografike dhe informata për kontakt për burimet dhe deri te fotografi që mund t'i shfrytëzoni në storie. Interneti sot është bërë vegël kryesore në punën e secilit gazetar hulumtues. Sidoqoftë, kur bëhet fjalë për shfrytëzimin e informatave dhe të dhënave prej Internetit, duhet të kemi parasysh që duhet të jemi shumë të kujdesshëm dhe të sigurohemi në autenticitetin e tyre. Disa prej gjërave që mund të na shërbejnë për kontrollim të faqes dhe të autenticitetit të informatave janë: burimi i shënuar qartë, mundësia për t'u kontrolluar legjitimiteti i atij që i publikon informatat, informatat e detajuara për kontakt, azhurnimi i rregullt i faqes, etj.


### 3.3.7. Vëzhgimi i drejtpërdrejtë në terren

Vëzhgimi i drejtpërdrejtë është prapëseprapë vegla më e fuqishme e secilit reporter. Puna në terren, përkatësisht në vendin ku ndodhin gjërat, mundëson që ta gjallëroni storien dhe ta bëni atë interesante për publikun tuaj. Vëzhgimi i drejtpërdrejtë i mundëson reporterit ta kuptojë më mirë temën që e hulumton. Gjithashtu, nëpërmjet vizitës së vendit të ngjarjes, reporteri mund t'ia lehtësojë vetes punën e mëtutjeshme për shkak se aty mund të gjejë dëshmitarë dhe burime për intervistim. Kur drejtpërdrejt i vëzhgoni ngjarjet që i hulumtoni, nuk e keni të domosdoshme të mbështeteni vetëm në informata të marra prej burimeve tjera, përkatësisht prej "dorës së dytë", të cilat mund të mos jenë tërësisht objektive. Përparësia e vëzhgimit të drejtpërdrejtë është që askush nuk do të mund të demantojë diçka që reporteri vetë e ka parë ose e ka dëgjuar.

### 3.3.8. Përcaktimi i kornizës kohore të hulumtimit

Nëse e paramendoni hulumtimin tuaj si një projekt të vogël, atëherë do ta keni më lehtë të kuptoni pse është mirë të keni kornizë kohore për realizimin e tij. Pasi që të vlerësoni sa kohë ju nevojitet në mënyrë optimale për hulumtimin, tregojani këtë redaktorit tuaj që të dijë kur mund të presë ta publikoni storien. Nga ana tjetër, kjo do t'ju bëjë presion që vazhdimisht të jeni të zgjuar dhe ta realizoni këtë afat.

Një prej karakteristikave themelore të gazetarisë hulumtuese është që ajo kërkon kohë. Vlerësoni realisht sa kohë ju nevojitet për t'i gjetur dokumentet dhe burimet e nevojshme dhe për t'i intervistuar. Gjithashtu, kini parasysh që pasi që t'i gjeni dokumentet dhe burimet që fillimisht i keni paraparë, ndoshta do të paraqitet nevoja për dokumente plotësuese dhe njerëz tjerë me të cilët do të duhet të bisedoni. Gjithashtu, parashihni që mund të vijë deri te shtyrja e disa bisedave. Kur e vlerësoni kohën e nevojshme për storien, jini realë dhe optimalë. Dijeni që këtë kohë e caktoni ju dhe që është e mundshme që ajo të ndryshohet, por gjithashtu kini parasysh edhe që publikimi i stories gjithmonë paraqet garë potenciale me mediat tjera të cilat ndoshta punojnë në storien e njëjtë.



### 3.3.9. Vlerësimi i parave të nevojshme për hulumtimin

Edhe pse në redaksitë gazetareske në vend janë të rralla rastet e parashikimit të fondit të posaçëm të parave, përkatësisht të buxhetit, për një hulumtim të caktuar, prapëseprapë duhet të vlerësoni a do të keni nevojë për shpenzime të jashtëzakonshme për gjërat e caktuara gjatë hulumtimit me qëllim që të mund ta përfundoni storien. Këtu bëhet fjalë për udhëtime të caktuara që ndoshta do ta keni të domosdoshme t'i bëni, për biseda telefonike, fotokopjim të materialeve, etj. Edhe pse në shumë raste shpenzimet e hulumtimit ndoshta do të mbuloohen në suaza të shpenzimeve të rregullta, prapëseprapë disa hulumtime ndoshta do të kërkojnë edhe shpenzime të jashtëzakonshme, për të cilat është mirë të kërkonte fond të posaçëm prej eprorëve tuaj. Edhe këtu duhet të jeni realë dhe optimalë, për shkak se ndonjëherë ndoshta për vetëm edhe pak para nuk do të mund ta përfundoni hulumtimin dhe ta publikoni storien. Kini parasysh që, përveç prej mediumit në të cilin punoni, fonde të parave për një hulumtim të caktuar mund të kërkonte edhe prej shoqatave të gazetarëve, organizatave joqeveritare mediale, si dhe prej donatorëve të jashtëm.

### 3.3.10. Organizimi i stories dhe vlerësimi i situatës

Pasi që t'i siguronit dokumentet dhe të dhënat e nevojshme dhe t'i intervistoni burimet, gjëja e ardhshme që duhet ta bëni është ta organizoni storien dhe të vlerësoni cilat janë informatat dhe njohuritë më të rëndësishme që i keni mbledhur. Me qëllim që të mundeni më së miri ta organizoni storien, do të ishte mirë që materialin me të cilin dispononi ta radhitni në mënyrë kronologjike. Gjithashtu, do të duhet patjetër të vlerësoni a do ta përmbledhni tërë materialin që e keni dhe do ta publikoni në një storie, ose do të vendosni të publikoni një seri të storieve. Nëse vendosni t'i publikoni njohuritë pjesë-pjesë, atëherë është mirë që të gjitha këto storie të kenë një titull të përbashkët për njohje më të lehtë, p.sh. "rasti XXX", ashtu që të mundet publiku të dijë që bëhet fjalë për një hulumtim të caktuar për një rast të njëjtë. Është shumë e rëndësishme që gjatë hulumtimit vazhdimisht ta vlerësoni situatën momentale që të mos ndodhë të humbeni edhe në hulumtimin, edhe në storien. Kjo do të thotë vazhdimisht të dini ku po shkon historia dhe deri ku po shkon, që të mund ta vlerësoni momentin kur veç më keni material të mjaftueshëm për publikim të stories. Prapëseprapë, duhet ta keni parasysh edhe atë që hulumtimi kërkon kohë dhe mos t'i nënshtroheni presionit të kohës - që, nëse ju nevojitet edhe ndonjë burim ose dokument, mos t'i pritni ato dhe ta publikoni storien pa to. Nga ana tjetër, vlerësimi i situatës është i rëndësishëm për të vlerësuar a jeni ndoshta në rrugë të gabuar dhe a duhet ndoshta ta ndërpritni hulumtimin për shkak se në të e humbni kohën tuaj dhe kohën e redaksisë në të cilën punoni.



### 3.3.11.

## Kontrollimi përfundimtar i stories

Para se të publikoni çfarëdo qoftë prej stories suaj, është shumë e rëndësishme që të bëni edhe një kontroll përfundimtar - a keni dëshmi për secilin pohim në storie. Këtu duhet të dini që nëse në storien tuaj gazetareske dikush fajëson dikë pa dëshmi, kjo nuk ju amnistion prej përgjegjësisë as juve, as mediumin në të cilin punoni. Duke pasur parasysh që njohuritë deri te të cilat keni ardhur nëpërmjet hulumtimit mund të shkaktojnë reaksione dhe pasoja serioze, mos ia lejoni vetes as gabimin më të vogël. Kushtoni vëmendje veçanërisht të madhe kontrollit të përsëritur të dokumenteve dhe të të dhënave. Kërkoni ndihmë prej njerëzve profesionistë për t'ua vërtetuar autenticitetin e të dhënave dhe të dokumenteve që i keni. Kontrolloni dy herë secilin numër dhe secilin emër dhe mbiemër. Përpuni që secilën njohuri ta kontrolloni edhe prej ndonjë burimi tjetër, përpos burimit prej të cilit e keni marrë. Krejt kjo është shumë e rëndësishme për shkak se madje edhe ndonjë gabim i paqëllimshëm ose i rastësishëm mund të ndikojë shumë negativisht mbi kredibilitetin e stories suaj, mbi ju si gazetar dhe mbi mediumin tuaj.

### 3.3.12.

## Shkrimi dhe publikimi i stories

Edhe pse gjatë hulumtimit keni mbledhur shumë informata, dokumente të ndryshme dhe kjo ndoshta ju ka zbuluar ndonjë situatë të ndërlikuar, prapëseprapë stória që do ta publikoni duhet të jetë e thjeshtë dhe e kuptueshme për publikun tuaj. Që të mund të shkruani storie të këtillë duhet ta përcaktoni këndin e stories duke e pyetur veten - për çka është stória juaj, përkatësisht çka dëshironi t'i thoni publikut me storien tuaj. Gjithashtu, gjatë tërë kohës duhet të keni fokus të qartë dhe të dallueshëm të stories, që do t'ju ndihmojë të bëni storie që do të ketë domethënie për publikun tuaj. Është shumë e rëndësishme të keni parasysh që këndi i stories dhe fokusi i saj nuk duhet të jenë patjetër të njëjta me hipotezën fillestare që e keni parashtruar për dëshmim që në fillim të hulumtimit. Shumë shpesh ndodh

që të ndërrohet fokusi i stories si rezultat i disa njohurive dhe dokumenteve të reja deri te të cilat keni ardhur gjatë hulumtimit.

Për të mos u humbur në storien tuaj gjithashtu është e rëndësishme të vlerësoni cilat prej të dhënave, dokumenteve dhe njohurive të mbledhura nuk janë të domosdoshme në storie dhe ato t'i lini anash, përkatësisht mos t'i publikoni. Përkujtohuni që shkruani storie gazetareske, e jo ndonjë hulumtim shkencor ose tekst akademik.

Që të mundet publiku juaj ta kuptojë storien më mirë, plotësojeni atë me grafikone, tabela dhe kuti në të cilat do t'i organizoni dhe paraqitni numrat kryesorë, pjesëmarrësit në hulumtim dhe kronologjinë e ngjarjeve. Ndani edhe dokumentet me publikun tuaj që ta rritni interesimin te ai, por edhe besimin duke treguar edhe letra, shënime, fotografi dhe dorëshkrime origjinale prej pjesëmarrësve në storie.

Storia hulumtuese të cilën do ta publikoni nuk duhet të mbetet vetëm në atë një tekst në gazetën tuaj ose shtojcë në radion ose televizionin tuaj. Duhet patjetër të vazhdoni me storien, duke i publikuar më pas të gjitha njohuritë e reja prej hulumtimit, secilin reaksion ose zgjidhje të asaj që e keni thënë në storie. Në të vërtetë, qëllimi i gazetarisë hulumtuese është të shkaktojë reaksion dhe avancim të ndonjë gjendjeje ose dukurie me çka, në fund të fundit, do të përmirësohen jeta dhe mirëqenia e njerëzve. Nëpërmjet publikimit të rezultatit të storieve, ata që kanë punuar në mënyrë të pandershme, të gabueshme dhe të paligjshme do ta dinë që në secilin moment mund të jenë të zbuluar dhe puna e tyre të bëhet publike. Nga ana tjetër, publiku do ta dijë që keqpërdorimeve mund t'u vijë fundi dhe që në të ardhmen do të ketë ku të drejtohet nëse është dëshmitar ose nëse ka njohuri për veprime të tilla.

## Aspektet ligjore dhe etike

Gazetaria hulomtuese zbulon diçka që njerëz ose institucione të caktuara dëshirojnë të mbetet fshehtësi dhe më së shpeshti përmban akuza për parregullsi të bërë, punë të gabueshme ose punë në kundërshtim me ligjet. Krejt kjo mund të shkaktojë pasoja të caktuara ndaj gazetarëve, në kuptim të asaj që disa prej njerëzve dhe institucioneve që janë përmendur në storie të ngrenë konteste gjyqësore kundër tyre, duke i paditur për shpifje ose fyerje.

Kur bëhet fjalë për aspektet ligjore të gazetarisë hulomtuese, është mirë të njihen dispozitat kyçe ligjore të cilat gazetarëve dhe mediave ua garantojnë të drejtën e informimit, kurse për bashkëbiseduesit e tyre përcaktojnë obligim që ta informojnë opinionin publik për punën e tyre, dispozitat të cilat gazetarëve u garantojnë qasje deri te informata të caktuara të cilat dikush ndoshta nuk dëshiron të publikohen, si dhe dispozitat të cilat i mbrojnë njerëzit dhe institucionet nga akuzat e pabaza, përkatësisht nga shpifja dhe fyerja. Kur bëhet fjalë për standardet etike të profesionit të gazetarisë, ato janë të përcaktuara në Kodin e gazetarëve të Maqedonisë, të sjellë në vitin 2001.



## 4.1. Liria e informimit publik

Bazën themelore ligjore që e garanton lirinë e informimit publik në Republikën e Maqedonisë e jep Kushtetuta. Përpos lirisë së informimit publik, neni 16 i Kushtetutës mes tjerash i garanton edhe qasjen e lirë deri te informatat, të drejtën e mbrojtjes së burimit të informatës dhe e ndalon cenzurën. Ky nen e garanton edhe të drejtën e korigjimit dhe të përgjigjes në media. Këto dispozita të Kushtetutës në të vërtetë u japin të drejtë gazetarëve të thirren në to gjithmonë kur kërkojnë informata për punën e një institucioni të caktuar ose të njerëzve të caktuar, dhe të cilat janë të rëndësishme për informimin e publikut.

### Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë

#### Neni 16

- Garantohet liria e besimit, ndërgjegjes, mendimit dhe shprehjes publike të mendimit.
- Garantohet liria e fjalës, paraqitjes publike, informimit publik dhe themelimit të lirë të institucioneve për informim publik.
- Garantohet qasja e lirë deri te informatat, liria e pranimit dhe transmetimit të informatave.
- Garantohet e drejta e përgjigjes në mjetet për informim publik.
- Garantohet e drejta e korigjimit në mjetet për informim publik.
- Garantohet e drejta e mbrojtjes së burimit të informatës në mjetet për informim publik.
- Cenzura është e ndaluar.

## 4.2. Qasja e lirë deri te informatat me karakter publik

Përpos Kushtetutës, qasje deri te informatat që kanë karakter publik gazetarëve u mundëson edhe Ligji relativisht i ri për qasje të lirë deri te informatat me karakter publik, i sjellë në vitin 2006. Duke u thirrur në dispozitat e këtij ligji, gazetarët mundën gojarisht, me shkrim ose nëpërmjet shkresës elektronike të kërkojnë informata prej organeve të pushtetit shtetëror dhe institucioneve tjera, organeve të komunave, institucioneve dhe shërbimeve publike, ndërmarrjeve publike, etj. Përpos në raste të cilat janë saktësisht të precizuara në nenin 6 të këtij ligji, poseduesit e informatave janë të obliguar që t'ia dorëzojnë informatat kërkuar në afat prej 30 ditëve dhe jo më vonë se 40 ditë nga dita e pranimi të kërkesës. Secili posedues i informatave është i obliguar që publikisht ta shpallë listën e informatave me karakter publik që i posedon.

## 4.3. Mbrojtja e privatësisë dhe të dhënave personale

Përkundër lirive gazetare dhe të drejtës së qytetarëve të jenë të informuar, të drejta dhe mbrojtje të veta kanë edhe njerëzit të cilët gazetarët i shfrytëzojnë si burime ose si pjesëmarrës në storiet e tyre. Secili njeri ka të drejtë të mbrojtjes së privatësisë së vet, të të dhënave të veta personale dhe të integritetit të vet personal. Së këndejmi, gazetarët duhet t'i respektojnë këto të drejta dhe mbrojtje të qytetarëve, përveç kur kjo është në kundërshtim me interesin publik.

Mbrojtja e të dhënave personale dhe të drejtat e privatësisë në lidhje me përpunimin e të dhënave personale rregullohen si liri dhe të drejta themelore të qytetarëve në pajtim me Ligjin për mbrojtje të të dhënave personale nga viti 2005. Në nenin 2 të këtij ligji, me të dhënë personale definohet secila informatë e cila ka të bëjë me ndonjë person të identifikuar fizik ose me ndonjë person fizik që mund të identifikohet në bazë të numrit të vetëm të amzës të qytetarit ose në bazë të një apo më shumë veçorive specifike për identitetin e tij fizik, mental, ekonomik, kulturor ose social.



## 4.4. Shpifja dhe fyerja

Gazetarët duhet të jenë shumë të kujdesshëm kur i publikojnë storiet e tyre hulumtuese dhe duhet të mbajnë llogari që të gjitha njohuritë në to të jenë të mbështetura me dëshmi përkatëse. Saktësia, balanca (paraqitja e të gjitha anëve në storie) dhe qasja e drejtë (paanshmëria ndaj cilësdo anë në storie) paraqesin bazë të secilës storie gazetareske dhe së këndejmi edhe të stories hulumtuese. Sipas Kodit penal të Maqedonisë, shpifja dhe fyerja paraqesin vepra penale. Këto dy vepra janë të rregulluara në nenet 172 dhe 173 të Kodit penal. Nga ana tjetër, Kodi parasheh edhe një varg rastesh të mosndëshkimit për veprat penale të shpifjes dhe fyerjes, të përcaktuara në nenin 176 të Kodit.

## 4.5. Çështjet etike

Çështjet etike në profesionin e gazetarisë në Maqedoni janë të rregulluara me Kodin e gazetarëve të Maqedonisë, i cili është sjellë në vitin 2001. Nënshkrues të Kodit janë gazetarë prej thujse të gjitha redaksive në Maqedoni, të cilat janë obliguar që gazetarët e tyre në punën e vet do t'i respektojnë normat e Kodit. Kodi i jep principet themelore etike dhe standardet themelore profesionale për sjelljen e gazetarëve. Për zbatimin e Kodit kujdeset Këshilli i nderit i Shoqatës së gazetarëve të Maqedonisë.



## 4.6. Kodi i gazetarëve të Maqedonisë

### Principet e sjelljes:

Liria e mediave është e drejtë e pacenueshme.

Detyra themelore e gazetarëve është ta respektojnë të vërtetën dhe të drejtën e opinionit publik të jetë i informuar në pajtim me nenin 16 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë.

Gazetarët kanë rol të transmetojnë informata, ide dhe mendime dhe të drejtë të komentojnë. Duke i respektuar vlerat etike dhe standardet profesionale në transmetimin e informatave, gazetarët do të jenë të ndershëm, objektivë dhe të saktë.

Është e drejtë dhe obligim i gazetarëve që të përpiqen ta pengojnë cenzurën dhe shtrembërimin e lajmeve.

Duke e ndjekur rolin e tyre në ndërtimin e demokracisë dhe të shoqërisë civile, gazetarët do t'i mbrojnë të drejtat e njeriut, dinjitetin dhe lirinë, do ta respektojnë pluralizmin e ideve dhe qëndrimeve, do të kontribuojnë për përforcimin e shtetit të së drejtës dhe në kontrollin e pushtetit dhe të subjekteve tjera të jetës publike.



## Në bazë të këtyre principeve dhe vlerave etike:

- 1.** Gazetari ka të drejtë të qasjes së lirë deri te të gjitha burimet e informimit që janë me interes publik.  
Gazetari duhet të publikojë informata të sakta, të kontrolluara dhe nuk do të fshehë të dhëna esenciale dhe nuk do të falsifikojë dokumente.  
Nëse informata nuk mund të vërtetohet, ose bëhet fjalë për supozim, përkatësisht spekulim, kjo duhet të thuhet dhe të publikohet.  
Saktësia e informatës duhet të kontrollohet sa që është e mundshme kjo.
- 2.** Nëse gazetari është i penguar të vijë deri te informata e kërkuar, ka të drejtë që për këtë ta informojë opinionin publik.
- 3.** Gazetari do të përpiqet që të sigurohet publikimi i korigjimit, demanteve dhe përgjigjes në rast kur do të konstatohet pasaktësia e informatës.
- 4.** Gazetari do ta bëjë me dije burimin e informatave, por nëse burimi kërkon të mbetet anonim, gazetari do ta mbrojë atë.
- 5.** Gazetari do t'i respektojë ligjet në shtet, por nuk do të publikojë ose fshehë diçka që është në kundërshtim me interesin publik.

- 6.** Gazetari nuk guxon ta shfrytëzojë mediumin për publikim ose fshehje të informatave për realizim të dobisë personale.  
Ryshfeti, korrupsioni dhe shantazhi janë të papajtueshëm me profesionin e gazetarisë.  
Nuk guxon të lejohet që reklamimi dhe motivet tjera komerciale të ndikojnë mbi lirinë e informimit.  
Duhet të ekzistojë kufizim mes reklamimit dhe tekstit gazetaresk me ilustrimin.
- 7.** Gazetari do ta respektojë privatësinë e personalitetit, përveç kur kjo është në kundërshtim me interesin publik.  
Gazetari është i obliguar t'i respektojë dhembjen dhe pikëllimin personal.
- 8.** Mënyra e informimit në raste të aksidenteve, fatkeqësive elementare, luftërave, tragjediive familjare, sëmundjeve, procedurave gjyqësore, duhet patjetër të jetë e liruar prej senzacionalizmave.  
Në procedurat gjyqësore duhet të respektohet principi i supozimit të pafajësisë, të raportohet për të gjitha palët e involvuara në kontest dhe mos të sugjerohet aktgjykimi.
- 9.** Gazetari nuk guxon të intervistojë ose të fotografojë fëmijë nën 16 vjet pa pajtimin e prindërve ose kujdestarëve, përveç nëse kjo nuk është në pajtim me të drejtat e fëmijës.  
E njëjta ka të bëjë edhe me personat me nevoja të posaçme, të cilët nuk janë në gjendje të rezonojnë në mënyrë të vetëdijshme.

- 10.** Gazetari nuk do të krijojë me vetëdije, e as nuk do të përpunojë me vetëdije informata që i kërcënojnë të drejtat ose liritë njerëzore, nuk do të flasë me gjuhën e urrejtjes dhe nuk do të nxisë dhunë dhe diskriminim sipas cilësdo baze (nacionale, fetare, racore, gjinore, sociale, gjuhësore, sipas orientimit seksual, politik...).
- 11.** Gazetari do t' u përmbahet edhe standardeve shoqërore të pranuar gjerësisht të mirësjelljes dhe respektimit të dallueshmërive etnike, kulturore dhe religjioze në Maqedoni.
- 12.** Plagjiatizmi është i papranueshëm.  
Citatet nuk guxojnë të shfrytëzohen pa u theksuar burimi ose autori.
- 13.** Gazetari duhet të bëjë dallim mes fakteve dhe mendimeve, mes lajmit dhe komentit.
- 14.** Raportimi prej proceseve politike, posaçërisht prej zgjedhjeve, duhet të jetë i paanshëm dhe i balancuar.  
Gazetari duhet patjetër të sigurojë distancë profesionale prej subjekteve politike.
- 15.** Gazetari duhet patjetër ta kultivojë kulturën e të folurit dhe etikën.  
Komunikimi i pasjellshëm me publikun është i papajtueshëm me profesionin e gazetarisë.
- 16.** Gazetari do t' i ruajë reputacionin dhe dinjitetin e profesionit të vet, do t' i nxisë solidaritetin e ndërsjellë dhe dallueshmërinë e qëndrimeve dhe nuk do ta shfrytëzojë mediumin e vet për qërim hesapesh me persona tjerë, duke i përfshirë edhe kolegët e vet.
- 17.** Gazetari ka të drejtë të refuzojë ndonjë detyrë pune nëse është në kundërshtim me principet e këtij Kodi.

### Dispozitat përfundimtare:

Gazetarët të cilët punojnë në pajtim me këtë Kodeks e gëzojnë përkrahjen e shtëpisë së tyre mediale dhe të organizatës së tyre profesionale.

Në pajtim me ligjet e Republikës së Maqedonisë, gazetarët do ta pranojnë gjyqin në lidhje me profesionin vetëm prej kolegëve të tyre dhe do të jenë jashtë ndikimit politik dhe ndikimeve tjera.

Për respektimin e principeve të Kodit kujdeset Këshilli i nderit i Shoqatës së gazetarëve të Maqedonisë.

CIP - Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека „Св. Климент Охридски“, Скопје

316.774/.776-027.541(497.7)(035)

DORACAK për mënyrën e raportimit për temat lokale  
dhe gazetarinë hulumtuese: Për mediat lokale / [në përgatitjen e tij merrnin  
pjesë German Fillkov dhe Sabina Fakiq; Përktheu: Gjakush Kabashi ]. - Скопје :  
Асоцијација за рурален развој, 2008. - 40 стр. ; 28 см  
ISBN 978-9989-2905-1-0

а) Медиуми, локални - Македонија - Прирачници

COBISS.MK-ID 73505546